



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Shkodër, më 11.11.2022



Nr. 6468 Prot
Dt. 16.11.22

Nr. 742/1 Prot.

Lënda: Kërkesë për trajtim.

ZYRËS SË ADMINISTRIMIT TË BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Për Informim: **KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS** ✓

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 25/1/c, të ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të VKM nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre”, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronesi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 6175 prot., datë 02.11.2022 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të datës 28.10.2022”, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 73, datë 28.10.2022 “Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 22.07 ha, për park fotovoltaik, aerogeneratorë, stacionet dhe objektet përkatëse, në ngastrën nr. 4, në ekonominë pyjore Drin Gjadër Kir”.

Për trajtim të mëtejshëm, Prefekti në rolin edhe si Kryetar i Këshillit të Basenit Ujor Drin Bunë, Ju kërkon të shpreheni nëse sipërfaqja e propozuar për dhënie në përdorim (ju dërgohet bashkëlidhur) e cituar si më sipër, përfshihet në basen dhe nuk bie ndesh me dispozitat e ligjit Nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i ndryshuar.

Mbetemi në pritje të përgjigjes suaj brenda 7 ditëve punë sipas VKM Nr.867/2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin;

P R E F E K T

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 742/3 Prot.



Shkodër, më 24.11.2022

M. 0184/1 Pro:
Dt. 30.11.22



Lënda: Përgjigje në vijim të shkresës së Prefektit Nr.742/1 prot datë 11.11.2022.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", pas administrimit të shkresës së ZABU Drin-Bunë nr. 483/1¹ prot., datë 18.11.2022 "Kthim përgjigje kërkesës për trajtim", në vijim të shkresës së Prefektit nr. 742/1 prot., datë 21.11.2022 "Mbi Vendimin nr. 73, datë 28.10.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës "Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 22.07 ha, për park fotovoltaiq, aerogeneratorë, stacionet dhe objektet përkatëse, në ngastrën nr. 4, ekonomia pyjore Drin Gjadër Kir", konstatohet se sipërfaqja përfshihet në brigjet e lumit Drin ndërmjet argjinaturës Mjedë-Ashtë duke konfirmuar se janë nën administrimin e Zyrës së Administrimit të Basenit Drin-Bunë.


Referuar ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 25 është në tagrin e Këshillit Bashkiak dhënia në përdorim e pronave me qëllim nxjerrjen e të ardhurave. Por një rast i tillë duhet të trajtohet edhe sipas ligjit të posaçëm Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar një regjim i ndryshëm juridik. Ky rast ju detyron të respektoni arsyetimin se kërkesat për veprimtari ndërtimore duhet të jenë për qëllime publike dhe mund të ushtrohen vetëm pasi të merret autorizimi i posaçëm nga organi përkatës për menaxhimin e burimeve ujore, ZABU Drin-Bunë, në zbatim të nenit 67 të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar.

Jeni të lutur të bashkëpunimin institucionalisht me Zyrën e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI



¹ Jeni informuar edhe ju si Këshill Bashkiak



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 73 datë 28.10. 2022



“Për dhënien në përdorim me afat 10 vjecar sipërfaqen pyjore prej 22.07 ha “për park fotovoltaiq”, aerogjeneratore (stacionet,objektet përkatëse etj),në ekonominë pyjore Drin Gjader Kir.

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020,date 30.4.2020 “Për Pyjet”,neni 25, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” **me shumicë të cilësuar votash:**

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej **22.07** ha “**për park fotovoltaiq**”, (**aerogjeneratorë,stacionet,objektet përkatëse etj**)në **ngastrën nr.4** të ekonomine pyjore **Drin Gjader kire.**
2. Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjetë) vjet me të drejtë rinovimi.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM-së **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”,Shtojca 1,pika 8/5.
4. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
5. Ngarkohen Drejtoria e Pyjeve,Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”)

K R Y E T A R

Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.11.2022